



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:094693  
Datë: 23.10.2024  
Numri i dokumentit: 06338680

**Ac.nr.7874/22**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli e Nehat Idrizi - anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësve V.Zh., V.Zh.1., S.K., N.I., N.Q., N.G. dhe A.A., që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av.B.K., nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit -Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson av.B.M., nga Prizreni, me objekt kontesti kompensimi i pagës jubilarë,, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren -departamenti i përgjithshëm, C.nr.833/21, të datës 18.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **21.10.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET pjesërisht e pathemeltë** ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa pika **I (një)** që ka të bëjë me kompensimin në emër të pagave jubilarë për paditësit V.Zh., N.G. dhe A.A., si dhe pika **II (dy)** që ka të bëjë me shpenzimet procedurale, të dispozitivit të aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren - departamenti i përgjithshëm C.nr.833/21, të datës 18.10.2022, **VËRTETOHET**.

**II. APROVOHET pjesërisht e themeltë** ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, **NDRYSHOHET** pika **I (një)** e dispozitivit të aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren - departamenti i përgjithshëm C.nr.833/21, të datës 18.10.2022 që ka të bëjë me kërkesëpadinë e paditësve V.Zh., S.K., N.I. dhe N.Q., të gjithë nga Prizreni për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe çështja gjykohet si në vijim:

- **Refuzohet** kërkesëpadia e paditësve V.Zh.1., S.K., N.I. dhe N.Q., të gjithë nga Prizreni, me të cilën kanë kërkuar “që të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve: **Paditëses V.Zh.**, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, apo 50 % të një page mujore (vlera e pagës 618.87 €), ti paguaj shumën prej **309.23 € (treqind e nëntë euro e njëzetë e tre cent)**. **Paditësit S.K.**, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, apo 50 % të një page mujore (vlera e pagës 513.22 €), ti paguaj shumën prej **256.61 € (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e një cent)**. **Paditësit N.I.**, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, apo 50 % të një page mujore (vlera e pagës

292.21€), ti paguaj shumën prej **146.10 € (njëqind e katërdhjetë e gjashtë euro e dhjetë cent)**. **Paditëses N.Q.**, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune, apo 75 % të një page mujore (vlera e pagës 509.00 €), ti paguaj shumën prej **381.75 € (treqind e tetëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë e pesë cent)**, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë 19.05.2021, deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm, **tërësisht e pabazuar**.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.833/21, të datës 18.10.2022, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve V.Zh., V.Zh., S.K., N.I., N.Q., N.G. dhe A.A..**DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që: **-Paditëses V.Zh.**, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, apo 50 % të një page mujore (vlera e pagës 618.87 €), ti paguaj shumën prej **309.23 € (treqind e nëntë euro e njëzetë e tre cent)**; **-Paditëses V.Zh.1**, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, apo 50 % të një page mujore (vlera e pagës 498.47 €), ti paguaj shumën prej **249.23 € (dyqind e katërdhjetë e nëntë euro e njëzetë e tre cent)**. **-Paditësit S.K.**, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, apo 50 % të një page mujore (vlera e pagës 513.22 €), ti paguaj shumën prej **256.61 € (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e një cent)**. **-Paditësit N.I.**, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, apo 50 % të një page mujore (vlera e pagës 292.21€), ti paguaj shumën prej **146.10 € (njëqind e katërdhjetë e gjashtë euro e dhjetë cent)**. **-Paditëses N.Q.**, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune, apo 75 % të një page mujore (vlera e pagës 509.00 €), ti paguaj shumën prej **381.75 € (treqind e tetëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë e pesë cent)**. **-Paditëses N.G.**, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune, apo 75 % të një page mujore (vlera e pagës 521.64 €), ti paguaj shumën prej **391.23 € (treqind e nëntëdhjetë e një euro e njëzetë e tre cent)**. **-Paditësit A.A.**, në emër të shpërblimit jubilar për 40 vite përvojë pune, apo 150 % të një page mujore (vlera e pagës 320.01 €), ti paguaj shumën prej **480.02 € (katërqind e tetëdhjetë euro e dy cent)**. Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë 19.05.2021, deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. Në pikën II (dy) e ka detyruar të paditurën Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës edhe atë: shumën në lartësi prej 332 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin e paraparë ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda të kthehet në rivnedosje ose i njëjti të ndryshohet dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pa bazë.

Paditësit, nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e palës së paditur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- *Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit V.Zh., V.Zh.1., S.K., N.I., N.Q., N.G. dhe A.A., që të gjithë nga Prizreni, me datën 19.05.2021, kanë paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensim i pagave jubilarë, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, pas marrjes së përgjigjes në padi jashtë seancës ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.833/2021 të datës 18.04.2022 me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të themeltë kërkesëpadinë e paditësve, dukevendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se midis palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune pranë SHFMU “Hasim Maliqaj” në fshatin Poslisht, Komuna e Prizrenit. Gjithashtu ka shtuar se sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur t’ia njoh të drejtën paditësit në kompensimin e shpërblimit jubilar, duke u bazuar në nenin 35 par.8 të Kontrata Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017. Për kamatën ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës konform nenit 452 të LPK-së (*më gjerësisht si në arsyetim të aktgjykimit të atakuar*).

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),( j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale vetëm për sa i përket aprovimit të kërkesëpadisë së paditësve V.Zh., S.K., N.I. dhe N.Q., të gjithë nga Prizreni për shpërblimin jubilar, gjë që u desh që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet për sa i përket kësaj pjese dhe të gjykohet si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Nuk mund të pranohet

pretendimi për këtë shkelje sepse ndryshimi i aktgjykimit ka të bëjë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale vetëm për pjesën e ndryshuar e jo me arsyetimin e gabuar. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë e ka përcaktuar edhe arsyetimin e aktgjykimit në atë mënyrë që përfundimi meritor është arsyetuar në përputhje me dispozitat e LPK-së, pavarësisht se një përfundim të tillë vetëm në pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, gjykata ankimore e ka ndryshuar.

Po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nga provat që ka administruar gjykata e shkallës së parë është vërtetuar se paditësit kanë qenë të punësuar tek e paditura SHFMU “Hasim Maliqaj” në fshatin Poslisht, Komuna e Prizrenit.

Përkitazi me kërkesëpadinë e paditësve V.Zh., N.G. dhe A.A. për kompensimin e shpërblimit jubilar, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar është i drejtë dhe i ligjshëm, mirëpo lidhur me kërkesën për kompensimin e shpërblimit jubilar për paditësit V.Zh.1, S.K., N.I. dhe N.Q., i njëjti është dashur të ndryshohet si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale vetëm në pjesën që ka të bëjë me kërkesën e paditësve të lartcekur në kompensimin e shpërblimit jubilar, për çka është dashur që të ndryshohet një pjesë e aktgjykimit të atakuar, përkatësisht sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitat e nenit 90 parag.1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me parag.1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me parag.3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me parag.4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017, përcaktohet se “*Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim*”. Me nenin 35 par.9 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi më 18.04.2017, përcaktohet se “*Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit*”. Nga

interpretimi i kësaj dispozite ligjore, Gjykata e Apelit, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, për arsye se paditësi është pensionuar me datën 08.03.2019, kohë kjo kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e arsimit e datës 18.04.2017 e cila i ka paraparë këto beneficione, andaj nga kjo edhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për këtë pjesë. Kurse sa i përket shpërblimit jubilar, me nenin 35 par.8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi më 18.04.2017, përcaktohet se *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë 8.1. për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë, 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, 8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti “*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, Gjykata e Apelit, nuk e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, për arsye se: Kontrata Kolektive e Arsimit, edhe pse ka qenë në fuqi në kohën e parashtrimit të padisë nga ana e paditësve (Kontrata Kolektive e Arsimit ka hyrë në fuqi më datë 18.04.2017- 21.01.2021) dhe e njëjta edhe pse është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 të Ligjit të Punës, në rastin konkret kërkesëpadia e paditësve V.Zh.1., S.K., N.I. dhe N.Q. është e pabazuar, për faktin se në këtë rast paditësit nuk i takojnë benefitet nga Kontrata Kolektive e Arsimit, duke marrë parasysh faktin se kontrata nuk ka qenë në fuqi në kohën kur paditësit e lartcekur ka arritur vitin jubilar për 10 vite përvojë pune (kjo pasi që nga provat në shkresat e lëndës është vërtetuar se paditësit me rastin e parashtrimit të padisë - datë 19.05.2021 kanë pasur përvojë pune 15 vite, përkatësisht 17 vite, që do të thotë se vitin jubilar e ka arritur në vitin 2014 dhe 2016, kur nuk ka qenë në fuqi kontrata kolektive). Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka konstatuar që kërkesëpadia e paditësve V.Zh.1., S.K., N.I. dhe N.Q. është e bazuar dhe ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimit. Prandaj nga arsyet e theksuara gjykata ankimore vlerëson se kërkesëpadia e paditësve të lartcekura për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, andaj vendosi që aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshoj.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar dispozitën e nenit 398 të LPK-së i cili shprehimisht përcakton *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritot, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”* Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka gjykuar këtë çështje kontestimore pa shqyrtim kryesor të çështjes pasi janë plotësuar kushtet ligjore në rastin konkret.

Në kuptim të lartcekurave kjo gjykatë ka vendosur që ta aprovoj pjesërisht të bazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ndryshuar me refuzimin e kërkesëpadiës së paditësit vetëm sa i përket kërkesëpadiës për shpërblimin jubilar.

Lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës, kjo gjykatë e ka vërtetuar pasi vlerësoi se është në përputhje me dispozita e LPK-së. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë

edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kumatën për pjesën vërtetuese si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit në bazë të nenit 194, 195 par.1 pika e), lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.7874/22, datë 21.10.2024**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**